

V E N D I M
Nr. 22/12, datë 23.10.2000

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN LOKAL PRIVAT “TV AVN”

SUBJEKTIT: SHOQËRISË “AVN+15” SH.P.K

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, SHOQËRISË “AVN+15” sh.p.k licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj license.
2. Licensa, bashkëlidhur, përmban kushtet e licensës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.